

VENDIM
Nr. 161, datë 5.6.2026

**MBI ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s,
LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “DRINI BULQIZË” SHPK
PËR TRANSFERIMIN E PLOTË TË LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERGIJISË
ELEKTRIKE TE SHOQËRIA “HEC POLEMI” SHPK**

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa “a”, dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 14, pika 3, “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 5.6.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1005/8 prot., datë 3.6.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Drini Bulqizë’ sh.p.k. për transferimin e plotë të licencës së prodhimit të energjisë elektrike te shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k.”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 577, seria P24, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 77, datë 29.4.2024, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Polemi”, me kapacitet të instaluar 1.751 mw, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës mbi tre degëzimet e Përroit të Neshtës, degë e Zallit të Kostenjës, Bashkia Librazhd, qarku Elbasan, për një afat 30-vjeçar.

- Në vijim të aplikimit të shoqërisë, të depozituar me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1005 prot., datë 30.3.2026 dhe dokumentacionit plotësues, të përcjellë me shkresën nr. 1005/1 prot., datë 7.4.2026, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 117, datë 24.4.2026, vendosi të fillojë procedurat për transferimin e plotë të licencës së shoqërisë, si dhe për dhënien e autorizimit për transferimin e aseteve të paluajtshme të HEC Polemit, nga shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. tek “HEC Polemi” sh.p.k.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 25.4.2026 dhe 27.4.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 4.5.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen e internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 1005/3 prot., datë 7.5.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimet e fillimit të procedurave respektive dhe në referencë të përcaktimeve të nenit 17, të rregullores së licencimit dhe nenit 7 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, ERE i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet në aplikimin e saj.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1005/6 prot., datë 12.5.2026, shoqëria ka kthyer përgjigje, por nuk ka depozituar të gjithë dokumentacionin e kërkuar, nga ku rezulton se duhet të depozitojë ende: shtojcën 1; qëndrimin e bankës për transferimin e aseteve; miratimin/qëndrimin e organit përkatës përgjegjës, në lidhje me transferimin apo përdorimin e lejes së ujit; të bëjë përditësimet mbi miratimet apo qëndrimet përkatëse mbi çdo dokument tjetër që i nënshtrohet transferimit; qëndrimin e MIE-s; si dhe kontratën e transferimit dhe shkresën drejtuar MIE-s në format origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin. Në lidhje me depozitimin e këtij

dokumentacioni, është vlerësuar dhe përgatitur shkresa përkatëse për shoqërinë “Drini Bulqizë” sh.p.k.

- Po ashtu, për vendimin e fillimit të procedurave nr. 117/2026, ERE ka njoftuar dhe MIE-n, nëpërmjet shkresës nr. 1005/4 prot., datë 7.5.2026, duke i kërkuar asaj që të bëjë me dije nëse nga ana e saj ka një qëndrim ndryshe, në lidhje me transferimin e licencës dhe aseteve të shoqërisë.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1005/7 prot., datë 28.5.2026, MIE ka bërë me dije se mbajtësi i miratimit, shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k., ka depozituar pranë saj kërkesën për miratimin e ristrukturimit organizativ apo transferimin e aktivitetit, shkresë të cilën shoqëria e ka vënë dhe në dispozicion të ERE-s, në kuadër të aplikimit për transferim. Po ashtu, MIE ka parashtruar se në kontratën e nënshkruar midis palëve, cilësohet se “Për çdo transferim të aksioneve/kapitalit themeltar tek të tretët, mbajtësi i miratimit duhet të marrë pëlqimin paraprak të ministrisë” dhe se kërkesa e shoqërisë është ende në fazë shqyrtimi nga ana e saj.

- Në vijim, ERE ka vlerësuar dhe përgatitur shkresën përkatëse për MIE-n, duke i sjellë në vëmendje se, sikurse njoftuar më herët, ERE ka nisur procedurat për transferimin e licencës dhe transferimin e aseteve të paluajtshme të shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k. te shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k. dhe jo për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj, por gjithsesi do të mbajë në konsideratë vlerësimin e MIE-s, duke i kërkuar që të depozitojë qëndrimin e saj në lidhje me sa referuar.

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 14, pika 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, Drini Bulqizë ndryshuar, dhe me qëllim për të zhvilluar korrespondencën vijuese me shoqërinë dhe MIE-n dhe depozitim të informacionit/dokumentacionit përkatës prej tyre, vlerësohet që të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, në lidhje me transferimin e plotë të licencës dhe transferimin e aseteve paluajtshme të HEC “Polemit”, nga shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. tek shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes mbi transferimin e licencës nr. 577, seria P24, dhënë shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 77, datë 29.4.2024, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Polemi”, me kapacitet të instaluar 1.751 mw, tek shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k..

2. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve të paluajtshme të HEC “Polemit”, nga shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. tek shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k.

3. Shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. duhet të depozitojë dokumentacionin e kërkuar brenda 20 (njëzet) ditëve.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Drini Bulqizë” sh.p.k., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

Petrit Ahmeti